

FTESË PËR OFERTË

HANDIKOS, Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës, nga viti 2019 është duke implementuar projektin “Promovimi i gjithëpërfshirjes në proceset konsultative për reformat e qeverisjes dhe administratës publike në sektorin e aftësisë së kufizuar në nivel lokal, nacional dhe regional”, në partneritet me organizata të personave me aftësi të kufizuara, dhe me financim të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë. Ndër aktivitete të tjera, në kuadër të këtij projekti janë të planifikuara një numër trajnimesh dhe punëtorish. Ndaj, për nevoja të implementimit të këtyre aktiviteteve, HANDIKOS është duke kërkuar ofertues për shërbime hotelerie në komunën e Prishtinës.

Të gjithë ofertuesit duhet të përfshijnë këto shërbime:

- Salla e trajnimeve e përshtatshme për deri 25 persona:
- Salla e trajnimeve e përshtatshme për deri 50 persona:
- Ofrimi i ujit për pjesëmarrës gjatë trajnimit (çmimi për një);
- Ofrimi i kafes për pjesëmarrës gjatë pauzave (çmimi për një);
- Dreka & pije jo-alkoolike për pjesëmarrës (ju lutem përshkruani cka përfshihet).

KRITERET PËR APLIKIM

- Duhet të ndodhen afër qendrës së Prishtinës;
- Duhet të kenë qasje fizike për personat me aftësi të kufizuara;
- Duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme në sallën e trajnimeve, që siguron akomodimin e pjesëmarrësve sipas llojit të sallës, duke respektuar distancën fizike;
- Duhet të këtë ndriçim të mjaftueshëm dhe hapësirë të përshtatshme për përdorimin e projektorit;

DOKUMENTET PËR DORËZIM DHE PËRMBAJTJA E OFERTËS:

- Çertifikata e regjistrimit të biznesit;
- Çmimet e shërbimeve në euro duke mos përfshirë TVSH-në (HANDIKOS është e liruar nga TVSH prandaj çmimet duhet të jenë pa TVSH);



- Oferta financiare e ndarë me çmime për: sallë, ujë, kafe dhe drekë & pije;
- Oferta duhet të jetë e nënshkruar dhe vulosur.

Të gjitha palët e interesuara ftohen të dorëzojnë ofertat e tyre në email-in: handikos@handi-kos.org, me mbishkrimin “Oferta për shërbime hotelerie”, më së largu deri më 22/12/2022. Ofertat e pranuar pas afatit të caktuar nuk do të merren në konsideratë.